Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim
Mbledhja nr. 59
Prishtinë, më 7.3.2023, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Besian Mustafa, Milazim Salijaj, Jetmira Vrenezi, Samra Ilijazi, Ekrem Mustafa, Albena Reshitaj dhe Isak Shabani.

Munguan: Ganimete Musliu dhe Salih Zyba.

Pjesëmarrës të tjerë: Bahrije Sadiku dhe Mirejta Shala nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë; Miranda Gashi, Elsa Berdynaj, Drilon Latifaj dhe Doruntina Alshiqi studentë të Fakultetit të Bujqësisë; Majlinda Shabani nga GP LVV dhe Egzon Ramadani, praktikant dhe Klan Kosova.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit**.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 21.2.2023;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-218 për organizimin e tregut për produktet bujqësore;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Komisioni, me 7 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 21.2.2023

Komisioni, me 7 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 21.2.2023.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-218 për organizimin e tregut për produktet bujqësore

Kryetarja, e paraqiti për shqyrtim Projektligjin dhe tha se ai i ka gjithsej 21 nene dhe ka për qëllim të rregullojë organizimin e tregut për produktet bujqësore, duke përfshirë kriteret, funksionin, themelimin dhe njohjen e organizatave të prodhuesve për përcaktimin e autoritetit kompetent për kontrollet e konformitetit të produkteve, në pajtim me standardet e tregut, kuadrin për futjen e skemave shkollore dhe kushtet e treguesve gjeografikë për prodhimin primar. Projektligji sipas Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave, nuk do të krijojë kosto shtesë buxhetore. Opinioni ligjor i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, thotë se Projektligji është pjesërisht në përputhje me Acquis të BE-së. Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 71 të Rregullores së Kuvendit.

Besian Mustafa, në lidhje me koston buxhetore të projektligjeve, tha se ato po vijnë në Kuvend me deklarimin se nuk kanë kosto buxhetore, ndërsa më vonë nuk po del ashtu. Si shembull për këtë, ai përmendi Ligjin për pasurimin e miellit, mbikëqyrjen e të cilit e kryeson dhe sugjeroi që mes dy leximeve të shikohet çështja e ndikimeve buxhetore të këtij projektligji.

Pasi që nuk pati diskutime të tjera kryetarja i ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

Rekomandim:

Të miratohet në parim Projektligji nr. 08/L-218 për organizimin e tregut për produktet bujqësore

4. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

E përgatiti: *Stafi mbështetës i Komisionit*

Fitore Pacolli-Dalipi,

Kryetare e Komisionit